

TITULLI I PROJEKTIT

SINJALISTIKA TURISTIKE

VLERA E PROJEKTIT

► € 59,106

KOHËZGJATJA E PROJEKTIT

► 5 muaj

SINJALISTIKA DHE PËRDITËSIMI I INFORMACIONEVE
RRITJA E AKSESUESHMËRISË SË SHTIGJEVE

PROJEKTI FINANCOHET NGA:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

INFORMACION I PËRGJITHSHËM



Titulli i projektit	Sinjalistika turistike
Emri i përfituesit	Bashkia Malësi e Madhe
Vendi i projektit	Malësi e Madhe
Kohëzgjatja e projektit	5 muaj
Shuma e kërkuar	€ 59,106
Objektivi i projektit	Përmirësimi i sinjalistikës turistike
Aktivitetet kryesore	Vendosja e sinjalistikës së nevojshme
Rezultatet e pritshme	Kompletimi atraksioneve turistike me sinjalistikën e përshtatshme për të rritur aksesueshmërinë.
Grupi(et) e synuara	Turistët dhe vizitorët që vizitojnë këto atraksione turistike
Përfituesit përfundimtarë	Subjektet që operojnë në fushën e turizmit në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe



GRUPET KRYESORE TË INTERESIT

Duke përmirësuar sinjalistikën turistike Bashkia Malësi e Madhe përmirëson cilësinë e shërbimeve ndaj vizitorëve dhe turistëve si rrjedhojë sjell rritjen e turistëve dhe vizitorëve, e cila përkthehet në rritjen e të ardhurave.

Grup tjetër të interesit janë edhe turistët dhe vizitorët sepse sa me cilësor dhe i dobishëm të jetë informacioni turistik aq me shumë dobi do të ketë.

Grup tjetër interesi janë edhe subjektet që operojnë në fushën e turizmit si prsh; sektori i hotelerisë, bujtinave, agjensitë turistike etj.

QELIMI DHE OBJEKTIVAT KRYESORE TË PROJEKTIT

Malësia e Madhe është portë hyrëse në Shqipëri. Pjesa e Alpeve Shqiptare ka pasuri natyrore dhe kulturore autoktone dhe unike, me histori dhe tradita dhe potenciale të larta për zhvillimin turistik të ekuilibruar, i lidhur me respekt ndaj mjedisit, të kombinuar me zhvillimin bujqësor dhe blegtoral, mjedisor e turistik me përfitime reciproke.

Objektivat kryesorë të këtij projekti janë:

01 Vendosija e sinjalistikës për atraksionet turistike

Kjo do të thotë që sa më shumë informacion të ketë për një atraksion turistik, sa më thjeshtë

të jetë rruga për të arritur atë, aq më shumë turistë do të vizitojnë këtë atraksion.

02 Përditësimi i informacioneve lidhur me atraksionet turistike

Duke parë zhvillimet e fundit që po ndodhin në infrastrukturën rrugore të Malësisë së Madhe është parë shumë e nevojshme që të përditësohet edhe infrastruktura e sinjalistikës turistike.

03 Rritja e aksesueshmërisë së shtigjeve për ecje

Vendosija e sinjalistikës treguese për mbërritjen në shtigjet për ecje (hiking), pasi mungesa e sinjalistikës bën që të mos arrihet potenciali që kanë këto shtigje për tërheqjen e turistëve dhe vizitorëve.



GJENDJA EKZISTUESE

Në sfidat e zhvillimeve afatmesme dhe afatgjata të ekonomisë shqiptare turizmi vlerësohet një nga sektorët më potencialë për të arritur një rritje ekonomike më të lartë dhe me efekte pozitive në rritjen e punësimit dhe të të ardhurave reale. Problematikat kryesore që hasen në fushën e shërbimeve, ekonomisë dhe turizmit, janë mungesa e vendeve të caktuara të parkimit, transporti urban i pastrukturuar dhe sinjalistika rrugore. Duke marrë parasysh që Bashkia Malësi e Madhe ka miratuar PPV, ku janë të ndërthurura Plani Sektorial i Alpeve, Plani i Parkut Natyror Rajonal Shkrel dhe Plani i Agjensisë Kombëtare të zonave të mbrojtura për liqenin e Shkodrës dhe strategjia e zhvillimit të Bashkisë vihet re mungesa e theksuar e sinjalistikës turistike. Pjesa më e madhe e monumenteve të natyrës dhe të

kulturës nuk kanë sinjalistikë informuese që përshkruajne monumentin dhe rëndësinë që ka, madje edhe ato që kanë sinjalistikë, e kanë të amortizuar dhe jo të përshtatshme. Në akset nacionale aktualisht mungon sinjalistika turistike ose është e paplotësuar mirë. Për sa iu përket rrugëve rurale, përvec Parkut Natyror në Shkrel, ka mungesë të plotë të sinjalistikës turistike. Ndër vite janë shënuar disa shtigje për ecje, ku edhe këto janë të shënuara sipas rregullave nderkombëtare, por sinjalistika që të çon deri te këto shtigje mungon. Mungojnë tabelat që tregojnë pikat e informacionit turistik (Koplik, Shkrel dhe Kelmend). Mungon hartografia për parqet brenda territorit të bashkisë. Mungon gjithashtu edhe sinjalistika që të çon në plazhet e liqenit të Shkodrës. Mungon sinjalistika që të con në luginat dhe kanionin e Sheut të Rrjollit.

TITULLI I PROJEKTIT

SINJALISTIKA TURISTIKE



RËNDËSIA E PROJEKTIT

Sipas PPV-së të Bashkise Malësi e Madhe është përsëritur disa here si në planin që parashikon zhvillimin e turizmit ashtu edhe në planin urbanistik të saj parashikohet përmirësimi dhe përditësimi i sinjalistikës turistike. Me miratimin e PPV-së janë miratuar edhe territore të caktuara të bashkisë të destinuara për zhvillim turistik. Rëndësia kryesore e këtij projekti është që t'ju shërbejë sa më qartë vizitorëve dhe turistëve, që janë dhe grupi me përfitimin më të lartë nga realizimi i këtij projekti. Sipas planit urbanistik dhe sipas planit të menaxhimit PNR Shkrel dhe planit të menaxhimit të zonave të mbrojtura janë përcaktuar vendet më të përshtatshme për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit. Një impakt relativisht pozitiv do të japë edhe për subjektet që operojnë në këtë fushë. Nga udhëzimet e ministrive të linjës

që vijnë herë pas here, kërkohet marrja e masave të menjëhershme për sinjalistikën turistike. Me zbatimin e këtij projekti ne i përshtatemi dhe plotësojmë kushtet dhe detyrimet ligjore që kërkon qeveria qendrore dhe operatorët turistikë që kërkojnë përmirësimin e standarteve të shërbimeve ndaj turistëve. Ky projekt na jep mundësinë që të jemi hapa përpara, po të krahasojmë shërbimet tona ndaj turistëve, në krahasim me bashkitë e tjera, duke orientuar edhe fluksin e brëndshëm të turistëve. Duke qënë se Bashkia Malësi e Madhe ka në territorin e saj një pjesë të Alpeve Shqiptare, ku janë edhe disa projekte që po promovojnë jo vetëm Alpet Shqiptare por edhe ato të rajonit, kërkojmë që të arrijmë standarte të larta shërbimi duke qënë konkurrentë jo vetëm në tregun shqiptar por edhe në tregun ndërkufitar.

TABELA 1 – OBJEKTIVAT, OUTPUTET, REZULTATET DHE AKTIVITETET

Objektivat e projektit	Outputet dhe rezultatet e pritshme	Aktivitetet
Përmirësimi i sinjalistikës turistike	<ul style="list-style-type: none"> Vendosja e 20 paneleve druri informuese me harta. Rifreskimi me bojë i nje pjese te sinjalistikës egzistuese të shtigjeve malore (101 m² lyerje me boje bikomponente) . Vendosja e 100 tabelave rrugore treguese 60x20 cm. Vendosja e 80 sinjaleve per lokalitetet HxL= 45x≠ Vendosja e 10 sinjaleve hotelerie 60x120cm. Vendosja e 30 tabelave katerkendore sherbimi 60x90 cm. Vendosja e 50 sinjaleve te drejtimit urban 25x125cm. Kryerja e punimeve te germimit te dheut me volum 50m³ dhe transportimi . Kryerja e punimeve te shtreses se zhorrorit me volum 8m³. Vendosja e 6 banerave 3x2 m. Printimi i 1000 fletepalosjeve 3 fold A+ 150gr. Pergatitja dhe printimi i 500 broshurave. Pergatitja e 1000 kartolinave 13x18cm. Kryerja e punimeve te shtreses se betonit C16/20 me volum 42m³. Realizimi i supervizionit, kolauditimit te punimeve. 	<ul style="list-style-type: none"> Do te vendosen panele druri informues me harta. Do te behet rifreskimi me boje i sinjalistikës egzistuese te shtigjeve malore per hiking. Do te vendosen tabela rrugore treguese 60x20cm. Do te vendosen sinjale per lokalitetet HxL=45x≠ Do te vendosen sinjale hotelerie 60x120 cm. Do te vendosen tabela sherbimi katerkendore 60x90 cm. Do te vendosen sinjale te drejtimit urban 25x125cm. Do te kryhen punime germimi dhe transporti. Do te kryhen punime shtresash betoni dhe zhorrori. Do te vendosen 6 banera 3x2 m. Do te pergatiten dhe printohen fletepalosje. Do te pergatiten broshura 300gr. Pergatitja e Kartolinave 13x18cm. Do te behet supervizioni dhe kolauidimi i punimeve.

TITULLI I PROJEKTIT

SINJALISTIKA TURISTIKE



TABELA 2 – PLANI INDIKATIV I AKTIVITETEVE PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT

Aktiviteti	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3	Muaji 4	Muaji 5
Dorëzimi i kërkesës së parafinancimit	■				
Procedurat e prokurimit	■	■			
Firmosja dhe menaxhimi i kontratave për të realizuar projektin		■	■		
Zbatimi i aktiviteteve të vizibilitetit të projektit		■	■	■	■
Paraqitja e raportit tremujor			■		
Paraqitja e raportit përfundimtar					■
Paraqitja e kërkesës për pagesën e vlerës së mbetur					■

IMPAKTI DHE QËNDRUESHMËRIA E PROJEKTIT

Impakti do të jetë direkt pozitiv sepse ky është një projekt i rekomanduar nga të gjitha subjektet që kanë studiuar sektorin e turizmit në Malësinë e Madhe.

Bashkia Malësi e Madhe për vitin 2018 e në vazhdim ka marrë disa masa si prsh:

Krijimi i një sektori të zhvillimit të turizmit, i cili ka për qëllim; promovimin, kontrollin, dhënien e informacioneve, hartimin e planeve të veprimit dhe planeve financiare për vitet në vazhdim. Planifikohet të ngarkohet sektori i zhvillimit të turizmit për hartimin e projektbuxhetit për sektorin e turizmit duke përfshirë edhe mirëmbajtjen e sinjalistikës turistike, për rrjedhoje burimet

financiare për mirëmbajtjen do ta marrë përsipër Bashkia Malësi e Madhe.

Ndërhyrjet në mjedis për realizimin e këtij projekti do të jenë minimale dhe për rrjedhojë nuk do të ketë ndikim negativ në mjedis. Grupet e vizitorëve dhe turistëve do të jenë të kënaqur me cilësinë e shërbimeve të marra për pasojë ata do të jenë të kënaqur dhe mund të rivizitojnë këto atraksione dhe mund të shpërndajnë informacion pozitiv e për rrjedhojë do të ketë një rritje të numrit të turistëve dhe vizitorëve, që është edhe qëllimi i Bashkisë Malësi e Madhe për sa i përket zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.

DETAJET E PERSONIT TË KONTAKTIT

Përfituesi	Bashkia Malësi e Madhe
Agjencia për Zhvillimin Rajonal Nr.	1
Adresa e përfituesit	Koplik-Qender
Faqja e internetit	www.bashkiamalesiemadhe.gov.al
Adresa e-mail	info@bashkiamalesiemadhe.gov.al
Nurmi i telefonit	+355 42253210
Numrin i Fax-it:	+355 42253210
Menaxheri i projektit	Erti Markaj
Pozicioni i punës të menaxherit të projektit	Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit të Turizmit
Numri i telefonit/celularit të menaxherit të projektit	+355 67 411 3458
Adresa e-mail të menaxherit të projektit	markajertil@gmail.com